

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar  
Financial Reporting

**P5**

Zgjidhjet

Data 22/01/2022

1. Vesuvius sh.a më 1 korrik 2021 bleu 60% të 75 milion aksioneve të ekuitetit me vlerë nominale prej €1 të Pinatubo sh.a. Blerja u arrit nëpërmjet këmbimit të një aksioni në Vesuvius sh.a për çdo tre aksione në Pinatubo sh.a. Në datën e blerjes, çmimet e aksioneve të Vesuvius sh.a dhe Pinatubo sh.a ishin €4 dhe €2.50, respektivisht. Veç kësaj, Vesuvius sh.a do të paguajë €1.54 para në dorë më 30 qershor 2022 për çdo aksion të blerë.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021:**

	Vesuvius sh.a	Pinatubo sh.a
	€'000	€'000
Shitjet	310,000	155,000
Kosto e shitjeve	<u>(200,000)</u>	<u>(75,000)</u>
Fitimi bruto	110,000	80,000
Shpenzimet e shperndarjes	(20,000)	(10,000)
Shpenzimet administrative	(18,000)	(12,500)
Të ardhurat nga investimet	2,500	800
Kosto financiare	<u>(1,000)</u>	<u>(2,800)</u>
Fitimi para tatimit	73,500	55,500
Tatimi në fitim	<u>(22,500)</u>	<u>(15,500)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>51,000</b>	<b>40,000</b>
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i>		
Përfitimimi (humbja) në rivlerësimin e tokës	<u>(1,100)</u>	<u>1,500</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>49,900</b>	<b>41,500</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- i) Më 1 korrik 2021, u krye një vlerësim i vlerave të drejta dhe u arrit në përfundim se vlerat vlerat në libra të pasurive neto të identifikueshme të Pinatubo sh.a ishin të barabarta me vlerat e tyre të drejta, me përjashtim të sa vijon:
  - Vlera e drejtë e tokës së Pinatubo sh.a ishte për €1 milion më e lartë se sa vlera e saj bartëse.
  - Një zë i fabrikës kishte një vlerë të drejtë prej €3 milion mbi vlerën e tij bartëse. Fabrika kishte një jetë të dobishme të mbetur prej dy vjetësh në datën e blerjes. Zhvlerësimi i fabrikës i ngarkohet koston së shitjes.
- ii) Pinatubo sh.a ka një brend të zhvilluar vetë që është vlerësuar €2.5 milion në datën e blerjes. Vesuvius sh.a pret që brendi të sjell përfitime për 5 vite të tjera. Amortizimi i pasurive të paprekshme i ngarkohet shpenzimeve administrative.
- iii) Është politikë e grupit të Vesuvius sh.a është të vlerësojë tokën me vlerën e drejtë në fund të çdo periudhe kontabël. Para blerjes, toka e Pinatubo sh.a ishte vlerësuar me kosto historike, por ajo ka adoptuar politikën e grupit që nga blerja e saj. Krahas rritjes së vlerës së drejtë në tokën Pinatubo sh.a, ajo pati një rritje të mëtejshme prej €0.5 milion që nga blerja.
- iv) Përfundimi me sukses i blerjes rezultoi në shitjen e mallrave nga Vesuvius sh.a tek Pinatubo sh.a me vlerë €10 milion. Më 31 dhjetor 2021, Pinatubo sh.a mbante ende në stoqe një të pestën e këtyre mallrave. Vesuvius sh.a ngarkoi një marzhë mbi kosto prej 25%.

- v) Me 1 korrik 2021, Vesuvius sh.a gjithashtu bleu 20% të aksioneve të ekuitetit të Cotopaxi sh.a. Fitimi pas tatimit i Cotopaxi sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 ishte €5 milion dhe gjatë dhjetorit 2021 Cotopaxi sh.a pagoi një dividend prej €3 milion. Megjithatë, Pinatubo sh.a nuk pagoi ndonjë dividendë në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.
- vi) Në dhjetor 2021, Vesuvius sh.a shiti mallra tek Cotopaxi sh.a për një shumë prej €7.5 milion. Të gjitha këto mallra ende ishin në stoqe të Cotopaxi sh.a me 31 dhjetor 2021. Vesuvius sh.a ngarkoi një marzhë mbi kosto prej 25%.
- vii) Vesuvius sh.a një kosto të kapitalit prej 10%. Faktorët e skontimit janë si më poshtë:
- | Viti | Faktori i skontimit 10% |
|------|-------------------------|
| 1    | 0.909                   |
| 2    | 0.826                   |
| 3    | 0.751                   |
- viii) Është politike e grupit Vesuvius sh.a të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së drejtë. Për këtë qëllim, çmimi i aksionit në datën e blerjes është tregues i vlerës së drejtë të aksioneve të mbajtura nga interesi jo kontrollues.
- ix) Fitimet e mbajtura të Pinatubo sh.a në fillim të vitit me 1 janar 2021 ishin €60 milion dhe ekuiteti përbëhej vetem nga kapitali aksionar dhe fitimet e mbajtura.
- x) Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet ndodhin njëtrajtësisht gjatë vitit, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.

**Kërkohe:**

- a) **Llogarite zërin e mirë në konsolidim në datën e blerjes.** (3 pikë)
- b) **Pergatite pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.** (17 pikë)

**(Total: 20 pikë)**

**1.**

<b>a) Llogaritja e zërit të mirë</b>	<b>€'000</b>
Konsiderata e blerjes:	
Aksionet (60% x 75,000 aksione x 1/3 x €4)	60,000
Knsiderata e shtyrë (60% x 75,000 aksione x €1.54 x 0.9091)	<u>63,000</u>
	123,000
Vlera e drejtë e IJK-së në datën e blerjes (40% x 75,000 aksione x €2.50)	<u>75,000</u>
	198,000
Neto pasuritë në datën e blerjes	<u>(161,500)</u>
	<b>36,500</b>

**b)****Grupi Vesuvius sh.a****Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021**

	<b>€'000</b>
Shitjet (€310,000 + (€155,000 x 6/12) - €10,000)	377,500
Kosto e shitjeve L13	<u>(228,950)</u>
Fitimi bruto	148,550
Shpenzimet e shperndarjes (€20,000 + (€10,000 x 6/12)	(25,000)
Shpenzimet administrative (€18,000 + (€12,500 x 6/12) + (€2,500/5 x 6/12)	(24,500)
Të ardhurat nga investimet: Pjesa e fitimit të shoqërisë (€5,000 x 20% x 6/12)	500
Të ardhurat tjera nga investimet (€2,500 - €600 div. nga shoqëria) + €800 x 6/12)	2,300
Kosto financiare (€1,000 + (€2,800 x 6/12) + (€63,000 x 10% x 6/12)	(5,550)
Fitimi para tatimit	96,300
Tatimi në fitim (€22,500 + (€15,500 x 6/12)	<u>(30,250)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>66,050</b>
<i>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</i>	
Humbja në rivlerësimin e tokës ((€1,100) - (€1,500 - €1,000)	<u>(600)</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>65,450</b>
Fitimi për vitin i atribuar:	
Aksionarëve të prindit (€66,050 - €7,600)	58,450
Interesave jo-kontrollues (€40,000 x 6/12 - €750 - €250 x 40%)	<u>7,600</u>
	66,050
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar:	
Aksionarëve të prindit (€65,450 - €7,800)	57,650
Interesave jo-kontrollues (€7,600 + (€1,500 - €1,000 x 40%)	<u>7,800</u>
	65,450

**L11 Struktura e grupit****Vesuvius sh.a**

Pinatubo sh.a	Cotopaxi sh.a
Grup1 60%	Grupi 20%
(6 muaj)	(6 muaj)
IJK40%	

**L12 Neto pasuritë - Pinatubo sh.a**

	€'000	€'000
	Data e blerjes	Data e raportimit
Kapitali aksionar	75,000	75,000
Fitimet e mbajtura: Saldo në fillim	60,000	
Plus (6/12 x €40,000)	<u>20,000</u> 80,000	100,000
Vlera e drejtë në datën e blerjes:		
Toka	1,000	1,000
Fabrika	3,000	3,000
Zhvlerësimi shtesë (€3m/2 vite x 6/12)	--	(750)
Brendi në datën e blerjes	2,500	2,500
Amortizimi shtesë (€2.5/5 vite x 6/12)	<u>-</u>	<u>(250)</u>
	<b>161,500</b>	<b>180,500</b>

**L13 Kosto e shitjes**

	€'000
Vesuvius sh.a	200,000
Pinatubo sh.a (€75,000,000 x 6/12)	37,500
Blerjet ndër-grupore	(10,000)
Zhvlerësimi shtesë (€3,000,000/ 2 vite x 6/12)	750
Fitimi i porealizuar në stoqe:	
Shitjet tek Pinatubo sh.a (€10,000 x 1/5 x 25/125)	400
Shitjet tek Cotopaxi sh.a (€7,500 x 20% x 25/125)	<u>300</u>
	<b>228,950</b>

2.

a) Mayon sh.a gjatë vitit 2021 ka 1,000,000 aksione të zakonshme në emetim dhe po ashtu gjatë vitit 2021 kishte në emetim:

- kredi të konvertueshme €2,000,000 me normë të interesit prej 14%, e cila mund të konvertohet brenda 3 viteve në 2 aksione të zakonshme për çdo €10 kredi.
- kredi të konvertueshme €5,000,000 me me normë të interesit prej 10%, e cila mund të konvertohet brenda 3 viteve në 3 aksione të zakonshme për çdo €5 kredi.
- Fitimi neto në vitin 2021 ishte €1,750,000. Norma e tatimit në fitim është 35%.

**Kërkohet:**

**Në pajtim me SNK 33 *Fitimet për aksion, llogaritni fitimet themelore dhe të dobësuara për aksion për vitin 2021.* (6 pikë)**

b) Yasur sh.a operon në industrinë minerare me një vit financiar që përfundon më 31 dhjetor 2021. Më 1 janar 2021, Yasur sh.a filloi të marr me lizing një grup makinerish që përdorshin në procesin e prodhimit. Lizingu ishte për pesë vjet, dhe pagesa totale vjetore (e pagueshme në fund të vitit) ishte €8 milion. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing është 10%. Jeta e dobishme ekonomike e vlerësuar e makinerive ishte pesë vjet.

Viti	FS @ 10%
1	0.909
2	0.826
3	0.751
4	0.683
5	0.621

**Kërkohet:**

**Në pajtim me SNRF 16 *Lizingjet, trego trajtimin në kontabilitet të lizingmarrësit transaksionit të mësipërm.* (7 pikë)**

c) Stromboli sh.a bleu një pronë të re (tokë dhe ndërtesa) në Prishtinë, më 1 janar 2019 për €42 milionë (përfshirë €17 milionë në lidhje me tokën). Prona u rivlerësua më 31 dhjetor 2020 në €45 milion (përfshirë €18.6 milion në lidhje me tokën). Elementi i ndërtesave do të zhvlerësohet për një jetë të dobishme 50-vjeçare me një vlerë të mbetur zero. Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur nuk kishin nevojë për rishikim më pas. Më 31 dhjetor 2021 prona u rivlerësua në shumë prej €37 milion pra rënie në vlerë si rezultat i recesionit (përfshirë €16 milion në lidhje me tokën).

Kompania bën transferim vjetor nga teprica e rivlerësimit në fitimet e pashpërndara në lidhje me zhvlerësimin e tepërt, siç lejohet nga SNK 16 *Prona, fabrika dhe paisjet.*

**Kërkohet:**

**Llogaritni shumat që duhet të raportohen në fitim ose humbje dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me ndërtesën për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021.** (7 pikë)

## 2.

### a)

FPA themelore = Fitimet/ numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme

FPA themelore = €1,750,000/1 milion = 1.75€

FPA e dobësuar = (Fitimet + fitimet e mundshme)

numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme + Numri i mundshëm i aksioneve

FPA e dobësuar llogaritet si në vijim:

Verifikimi nëse kreditë e konvertueshme janë dobësuese.

- kredi të konvertueshme €1,000,000 me normë të interesit prej 14%:  
 $2,000,000/10 \times 2 = 200,000$  aksione të zakonshme  
 $2,000,000 \times 14\% \times 65\% = €182,000$  fitim shtesë pas tatimit.

Kjo kredi ka një FPA prej,  $(182,000/200,000)$  0.91 dhe është më e ulët se FPA themelore dhe kredia është dobësuese.

- kredi të konvertueshme €5,000,000 me normë të interesit prej 10%:  
 $5,000,000/5 \times 3 = 3,000,000$  aksione të zakonshme  
 $5,000,000 \times 10\% \times 65\% = €325,000$  fitim shtesë pas tatimit.

Kjo kredi ka një FPA prej  $(325,000/3,000,000)$  0.1083 dhe është më e ulët se FPA themelore dhe kredia është dobësuese.

LLogaritja e FPA-së Dobësuese

$(1,750,000+182,000+325,000)/(1,000,000+200,000 + 3,000,000) = 53.74$  cent

### b) Pasuria nën lizing

	€'000
Kosto	30,320
Zhvlerësimi për vitin	<u>(6,064)</u>
	24,256

Lizingmarrësit i kërkohet sipas SNRF 16 të njohë një pasuri me të drejtë të përdorimit dhe një detyrim përkatës. Prandaj, €30.320 milionë do të përfshihen sipasuri ashtu edhe si detyrim ndaj lizingut në njohjen fillestare. Detyrim ndaj lizingut trajtohet si më poshtë:

Viti	Saldo në fillim	Kosto financiare	Qiraja	Saldo në fund
	€'000	€'000	€'000	€'000
31 dhjetor 2021	30,320	3,032	(8,000)	25,352
31 dhjetor 2022	25,352	2,535	(8,000)	19,887

Pasqyra e fitimit ose humbjes në vitin e parë do të përfshijë një kosto financiare prej €3.032 milion dhe një zhvlerësim prej €6.064 milion.

Pasqyra e pozitës financiare do të përfshijë detyrimin ndaj lizingut në fund në vitin aktual, €25.352 milion nga të cilat €19.887 milion është një detyrim afatgjatë dhe €5.465 milion është një detyrim afatshkurtë. Pasuria me të drejtë të përdorimit prej €30.320 milion do të zhvlerësohet gjatë pesë viteve  $(€30.320 \div 5 \text{ vjet}) = €6.064$  milion. Prandaj, pasuria do të njihet në pasqyrën e pozitës financiare në vlerën €24.256 milion (dmth. €30.320 - 6.064).

Përndryshe, detyrimi afatshkurtë ndaj lizingut €5.465 milion (€8 milion - €2.535 milion) dhe detyrimi afatgjatë ndaj lizingut është €19.887 milion (€25.352 - €19,887)

Llogaritjet:

Detyrimi ndaj lizingut =  $3.971 \times €8 \text{ million} = 30.320 \text{ million}$

Llogaritjet

Viti	FS @ 10%	Pagesat '000	VTN
1	0.909	8,000	7,272
2	0.826	8,000	6,608
3	0.751	8,000	6,008
4	0.683	8,000	5,464
5	0.621	8,000	<u>4,964</u>
			30,320

### c) Rivlerësimi i Pronës, fabrikës dhe paisjeve

	Toka €'000	Ndërtesat €'000	Total €'000
Kosto 1 janar 2019	17,000	25,000	42,000
Zhvlerësimi i akumuluar (25,000/50 vite x 2 vite)	0	(1,000)	(1,000)
Vlera bartëse 31 dhjetor 2020	17,000	24,400	39,000
Përfitimimi nga rivlerësimi (Saldo)	<u>1,600</u>	<u>2,400</u>	<u>4,000</u>
Shuma e rivlerësuar 31 dhjetor 2020	18,600	26,400	45,000
Zhvlerësimi (26,400/48)	-	(550)	(550)
	18,600	25,850	44,450
Humbja nga rivlerësimi (Saldo)	<u>(2,600)</u>	<u>(4,850)</u>	<u>(7,450)</u>
Shuma e rivlerësuar 31 dhjetor 2021	16,000	21,000	37,000

Transfer (zhvlerësimi shtesë)  $24,000/48 \text{ vite} = 50$

### Stromboli sh.a

Ekstrakt i pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitet deri me 31 dhjetor:

	2021 €'000	2020 €'000
Zhvlerësimi	550	500 (25,000/20)
Humbja nga rivlerësimi (7,450-3,950*)	3,500	0
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	0	4,000

\* Saldo e rezerves së rivlerësimit me 31 dhjetor 2021 është  $4,000 - 50 = 3,950$



3. Informatat në vijim kanë të bëjnë me draft pasqyrat financiare të Krakatoa sh.a.

**Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor:**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet (shënim (i))	65,200	48,200
Pasuritë financiare: investimet në ekuitet (shënim (ii))	<u>9,000</u>	<u>14,000</u>
	74,200	62,200
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	20,400	14,400
Të arkëtueshmet tregtare	7,000	7,400
Banka	<u>-</u>	<u>2,800</u>
	<u>27,400</u>	<u>24,600</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>101,600</b>	<b>86,800</b>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
<u>Ekuiteti:</u>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila (shënim (iii))	28,000	16,000
Premia e aksioneve (shënim (iii))	-	4,000
Rezerva e rivlerësimit (shënim (iii))	4,000	7,200
Fitimet e mbajtura	<u>26,000</u>	<u>20,200</u>
	58,000	47,400
<u>Detyrimet afatgjata:</u>		
Detyrimet ndaj lizingut	14,000	13,800
Tatimi i shtyrë	2,600	1,800
<u>Detyrimet afatshkurtëra:</u>		
Tatimi	2,000	2,400
Mbiterheqja bankare	5,800	-
Provizionet për garancionet e produkteve (shënim (iv))	3,200	8,000
Detyrimet ndaj lizingut	9,600	4,200
Të pagueshmet tregtare	<u>6,400</u>	<u>9,200</u>
Total detyrimet	<u>43,600</u>	<u>39,400</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>101,600</b>	<b>86,800</b>

**Pasqyra e Fitimit ose Humbjes me 31 dhjetor:**

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të ardhurat	117,000	82,000
Kosto e shitjeve	<u>(93,000)</u>	(60,000)
Fitimi bruto	24,000	22,000
Shpenzimet operative	(17,400)	(9,000)
Të ardhurat nga investimet (shënim (ii))	2,200	1,400
Kosto financiare	<u>(1,000)</u>	<u>(400)</u>
Fitimi para tatimit	7,800	14,000
Shpenzimi i tatimit në fitim	<u>(1,000)</u>	<u>(3,600)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>6,800</b>	<b>10,400</b>

**Informatat shtesë në vijim janë në dispozicion:****(i) Prona, fabrika dhe pajisjet:**

Krakatoa sh.a ka një politikë të paraqitjes së Pasurive me të Drejtë të Përdorimit brenda pronës, fabrikës dhe pajisjeve. Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2021, shtimet në Pasuritë me të Drejtë të Përdorimit arritën në €13.4 milionë. Një pronë me vlerë në libra prej €8 milion është shitur gjatë vitit deri më 31 dhjetor me një çmim prej €16.2 milion. Ngarkesa e zhvlerësimit për vitin për pronat, objektet dhe pajisjet, përfshirë zhvlerësimin e pasurive me të drejtë të përdorimit ishte €5 milionë.

(ii) Dividentët e pranuar nga pasuritë financiare të ekuitetit gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2021 arritën në €400,000. Përveç të ardhurave nga dividentët, zëri për të ardhurat nga investimet përfshin fitimet/humbjet nga rimatja dhe shitja e pasurive financiare të ekuitetit. Pasuritë financiare të ekuitetit me vlerë në libra prej €6 milion janë shitur gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2021. Nuk ka pasur shtesa në pasuritë financiare të ekuitetit.

(iii) Me 1 korrik 2021 ka pasur një emetim bonus të aksioneve që është financuar nga premia e aksioneve dhe disa prej rezervave të rivlerësimit. Kësaj i pason me 30 shtator 2021 një emetim për para sipas vlerës nominale. Nuk ka pasur rivlerësim të pronës, fabrikes dhe pajisjeve apo transfere tek fitimet e mbajtura nga rezerva e rivlerësimit gjatë periudhës.

(iv) Provizionet për garancionet e produkteve janë përfshirë në kostot e shitjes.

**Kërkohet:**

**Përgatite pasqyrën e rrjedhës së parasë të Krakatoa sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021, në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë duke përdorur metodën indirekte. (20 pikë)**

### 3 Pasqyra e rrjedhës së parasë së Krakatoa sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

	€'000	€'000
Fitimi para tatimit		7,800
Kosto financiare		1,000
Të ardhurat nga investimet		(2,200)
Përfitimi nga shitja e PFP (16,200-8,000)		(8,200)
Zhvlerësimi		5,000
Rritja/ zvogëlimi në:		
Stoqe (20,400-14,400)		(6,000)
Të arkëtueshmet tregtare (7,000-7,400)		400
Provizionet për garancionet e produkteve (3,200-8,000)		(4,800)
Të pagueshmet tregtare (6,400-9,200)		<u>(2,800)</u>
Rrjedhat e parasë nga operaconet		(9,800)
Tatimi në fitim i paguar (L11)		(600)
Dividenda e paguar (L12)		(1,000)
Interesi i paguar (L13)		<u>(1,000)</u>
<b>Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative</b>		<b>(12,400)</b>
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese:		
Blerja e PFP (L14)	(16,600)	
Shitja e PFP	16,200	
Shitja e pasurive financiare (6,000+800[L15])	6,800	
Dividenda e arkëtuar	<u>400</u>	
<b>Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese</b>		<b>6,800</b>
Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese:		
Emetimi i aksioneve (L16)	4,800	
Pagesa e detyrimeve ndaj lizingut (L17)	<u>(7,800)</u>	
<b>Neto rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese</b>		<b>(3,000)</b>
<b>Ndryshimet në paranë dhe ekuivalentët e parasë</b>		<b>(8,600)</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim</b>		<b><u>2,800</u></b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund</b>		<b>(5,800)</b>
<b>Llogaritjet:</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<b>L11. Tatimi në fitim i paguar</b>		
Detyrimet e tatimit në fitim në fillim		
Tatimi aktual	2,400	
Tatimi i shtyrë	1,800	
Tatimi në fitim për periudhën	<u>1,000</u>	
		5,200
Tatimi i paguar (shifër balancuese)		(600)
Detyrimet e tatimit në fitim në fund:		
Tatimi aktual	2,000	
Tatimi i shtyrë	<u>2,600</u>	4,600

	€'000	€'000
<b>L12. Dividenda e paguar</b>		
Fitimet e mbajtura në fillim		20,200
Fitimi për periudhën		6,800
		<u>27,000</u>
Dividenda e paguar (shifër balancuese)		(1,000)
Fitimet e mbajtura në fund		26,000
<b>L13. Interesi i paguar</b>		
Detyrimet ndaj interesit në fillim		0
Kosto financiare		1,000
Interesi i paguar (shifër balancuese)		<u>(1,000)</u>
Detyrimet ndaj interesit në fund		0
<b>L14. Paraja e paguar për PFP</b>		
Saldo në fillim		48,200
Zhvlerësimi për vitin		(5,000)
Shtimet jo në para nepermjet PMP		13,400
Largimet		<u>(8,000)</u>
		48,600
Shtimet në para (shifër balancuese)		16,600
Saldo në fund		65,200
<b>L15. Shitja e pasurive financiare</b>		
Total të ardhurat nga investimet		2,200
Minus: Dividenda e arkëtuar		(400)
Përfitimi/humbja nga rimatja [9,000-(14,000-6,000)]		<u>(1,000)</u>
Përfitimi nga shitja e pasurive financiare		800
<b>L16. Emetimi i aksioneve</b>		
Kapitali aksionar në fillim		16,000
Emetimi bonus:		
Premia e aksioneve		4,000
Rezerva e rivlerësimit (7,200-4,000)		<u>3,200</u>
		23,200
Emetuar për para (shifër balancuese)		<u>4,800</u>
Saldo në fund		28,000
<b>L17. Paguesa e detyrimeve ndaj lizingut</b>		
Detyrimet ndaj lizingut në fillim		
Afatshkurtër	4,200	
Afatgjatë	13,800	
Shtimet për PMP	<u>13,400</u>	
		31,400
Paraja e paguar për detyrimet ndaj lizingut (shifër balancuese)		(7,800)
Detyrimet ndaj lizingut në fund		
Afatshkurtër	9,600	
Afatgjatë	<u>14,000</u>	
		23,600

4.

a) Mauna Loa sh.a operon raporton sipas SNRF-ve. Pasqyrat financiare të Mauna Loa sh.a për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë ende në formë drahti. Auditimi është në vazhdim e sipër dhe kompania synon të publikoj pasqyrat financiare me 30 prill 2022.

Mauna Loa sh.a ka një depo në Pejë. Më 3 janar 2021, për shkak të vershimeve nga reshjet e dendura, stoqet me vlerë në libra prej €650,000 të Mauna Loa sh.a-së u shkatërruan nga përmbytjet. Stoqet nuk ishin të siguruar dhe Mauna Loa sh.a nuk do të marrë asnjë kompensim për humbjen. Mauna Loa sh.a nuk është e sigurt se si të kontabilizoj këtë ngjarje. Stoqet e shkatërruara përfshihen në shifren e stoqeve në draft-pasqyrën e pozitës financiare të Mauna Loa sh.a më 31 dhjetor 2021. Vlera në libra e stoqeve është materiale për pasqyrat financiare.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni me arsyetim trajtimin e duhur kontabël të ngjarjes së mësipërme. (4 pikë)**

b) Mazama sh.a është në procesin e kontabilizimit për blerjen e një filiali tjetër, Kilauea sh.a dhe ka identifikuar një sërë çështjesh gjatë rishikimit të vlerave të drejta të pasurive të Kilauea sh.a.

Një nga çështjet lidhet me një padi ligjore në të cilën Kilauea sh.a është paditur nga një prej klientëve të saj për gjoja furnizimin e mallrave me defekt dhe klienti po kërkon dëmshpërblim në shumën €4 milion. Ekipi ligjor i Kilauea sh.a ka këshilluar se, bazuar në të gjitha faktet, ka shumë pak gjasa që gjykata të vendosë që t'i jipet dëmshpërblim klientit. Vlera e drejtë e detyrimit kontigjent në lidhje me pretendimin është vlerësuar nga drejtorët e Mazama sh.a në €1.1 milion, bazuar në probabilitetin shumë të ulët që klienti të ketë sukses. Kilauea sh.a ka zbatuar saktë SNK 37 *Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente* në përgatitjen e pasqyrave të saj financiare duke e trajtuar padinë si një detyrim kontigjent.

**Kërkohet:**

**Tregoni nëse (dhe nëse po, me çfarë vlere) duhet të njihet kjo ngjarje në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Mazama sh.a për blerjen e Kilauea sh.a. (5 pikë)**

c) Bromo sh.a ka stoqe në fund të periudhës raportuese si në vijim.

	Njësiti	Kosto e lëndës së parë €	Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit të atribuara €	Shpenzimet e shitjes të atribuara €	Çmimi i prituri i shitjes €
Artikulli A	216	189	12	11	240
Artikulli B	426	206	20	16	230
Artikulli C	158	53	14	9	75

**Kërkohet:**

**Në çfarë shume do të paraqiten stoqet në pasqyrën e pozitës financiare në pajtim me SNK 2 Stoqet? (6 pikë)**

**d) SNK 28** *Investimet në shoqëri dhe sipermarrje të përbashkëta* përkufizon një shoqëri si një entitet mbi të cilin një investitor ka ndikim domethënës dhe i cili nuk është as degë (filial) e as interes në një ndërmarrje të përbashkët. Ndikimi domethënës mund të përcaktohet përmes mbajtjes së të drejtave të votimit (zakonisht bashkangjitur me aksione) në entitet. SNK 28 thekson se nëse një investues mban 20% ose më tepër të fuqisë votuese të pranuesit të investimit, mund të presupozohet se investuesi ka ndikim domethënës mbi të, pos nëse mund të dëshmohet se nuk është ashtu.

Ndikimi domethënës mund të presupozohet se nuk ekziston nëse investuesi mban më pak se 20% të fuqisë votuese të marrësit të investimit, pos nëse mund të dëshmohet se është ndryshe

**Kërkohet:**

**Identifiko pesë (5) faktorë që janë tregues të ndikimit domethënës.**

**(5 pikë)**

**a)** SNK 10 *Ngjarjet pas Periudhës Raportuese* është standardi i kontabilitetit i aplikueshëm. SNK 10 përshkruan se një "ngjarje pas periudhës raportuese" është një ngjarje që ndodh midis fundit të periudhës raportuese dhe datës kur pasqyrat financiare janë autorizuar për publikim. Standardi bën dallimin ndërmjet ngjarjeve korigjuese dhe jo-korigjuese. Ngjarjet korigjuese ofrojnë dëshmi për kushtet që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese. Ngjarjet korigjuese duhet të korigjohen në pasqyrat financiare.

Ngjarjet jo-korigjuese janë ngjarje që janë tregues të kushteve që janë paraqitur pas periudhës raportuese. Nuk bëhen korigjime për ngjarjet jo-korigjuese. Përmbytja ndodhi më 3 janar 2021. Gjendja (përmbytja dhe dëmtimi i stoqeve) ekzistonte në datën e raportimit më 31 dhjetor 2021. Prandaj, ngjarja është një ngjarje korigjuese dhe Mauna Loa sh.a duhet të korigjoj pasqyrat financiare të vitit 2021 për humbjen e stoqeve €650,000.

**b)** SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit* kërkon që të gjitha kombinimet e biznesit duhet të kontabilizohen duke përdorur metodën e kontabilitetit të blerjes. Kontabiliteti i blerjes kërkon që blerësi në një kombinim duhet të njohë pasuritë dhe detyrimet e identifikueshme të blera me vlerat e tyre të drejta. Çdo ndryshim midis totalit të kostos së blerjes dhe vlerës së interesit jo-kontrollues në matjen e tyre fillestare, dhe vlerës së drejtë të pasurive neto të identifikueshme të blera duhet të njihet si emri i mirë në konsolidim. Në përgjithësi, çdo pasuri ose detyrim i blerë, vlera e drejtë e të cilit mund të matet në mënyrë të besueshme nga drejtorët duhet të trajtohet si një pasuri ose detyrim i identifikueshëm i entitetit të blerë dhe si rrjedhim të njihet si pjesë e pasurive neto të identifikueshme të blera.

Në lidhje me detyrimin kontingjent, duhet theksuar në radhë të parë se kriteri i njohjes SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente* është i ndryshëm nga ai në SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*. Detyrimi kontingjent nuk u njoh nga Kilauea sh.a në pasqyrat e veta financiare të veçanta, sepse sipas SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente*, nuk ka gjasa që të transferohen përfitime ekonomike. Në lidhje me SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*, mjafton vetëm që drejtorët të mund të matin në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të detyrimit kontingjent që ai të njihet.

Prandaj, detyrimi kontingjent do të njihet si një nga pasuritë neto të identifikueshme të Kilauea sh.a në blerjen e tij nga Mazama sh.a. Fillimisht do të matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes prej €1.1 milion. Kjo do të çojë në një humbje të vlerës së drejtë nga detyrimet (në rritje të detyrimeve) dhe si rrjedhim një reduktim në vlerën e drejtë të pasurive neto të blera. Efekti i përgjithshëm do të jetë rritja e emrit të mirë në blerje dhe një rritje e mundshme e fitimeve pas blerjes nga Kilauea sh.a. Çdo ndryshim në detyrimin kontingjent do të raportohet më pas në fitim ose humbje.

c)

	<b>Njësiti</b>	<b>Kosto</b>	<b>VNR</b>	<b>Më e ulëta</b>	<b>Total</b>
		€	€	€	€
Artikulli A	216	201	229	201	43,416
Artikulli B	426	226	214	214	91,164
Artikulli C	158	67	66	66	10,428
					<u><b>145,008</b></u>

d) Ekzistenca e ndikimit domethënës dëshmohe në njëri nga mënyrat në vijim.

- 1 Përfaqësimi në bordin e drejtorëve (ose ekuivalent) të marrësit të investimit
- 2 Pjesëmarrja në procesin e bërjes së politikës
- 3 Transaksionet materiale në mes të investuesit dhe marrësit të investimit
- 4 Ndërkëmbimi i personelit të menaxhmentit
- 5 Ofrimi i informatave thelbësore teknike



5. Ju jeni Kontrollori Financiar i Pacaya sh.a-së një kompani prodhuese e cila operon për më shumë se 20 vite. Përmbledhjet e pasqyrave të fitimit ose humbjes dhe pozitës financiare të Pacaya sh.a-së për tre vitet e mëparshme janë dhënë më poshtë.

**Pasqyra e përmbledhur e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor**

	2021 €'milion	2020 €'milion	2019 €'milion
Të hyrat	913	981	840
Kosto e shitjes	<u>(590)</u>	<u>(645)</u>	<u>(554)</u>
Fitimi bruto	323	336	286
Shpoenzimet administrative dhe te shitjes	<u>(219)</u>	<u>(214)</u>	<u>(186)</u>
Fitimi para interest dhe tatimit	104	122	100
Kosto financiare	<u>(19)</u>	<u>(15)</u>	<u>(6)</u>
Fitimi para tatimit	85	107	94
Tatimi	<u>(45)</u>	<u>(52)</u>	<u>(45)</u>
<b>Fitimi pas tatimit</b>	<b>40</b>	<b>55</b>	<b>49</b>

Pacaya sh.a ka paguar dividend prej €24 milion çdo vit në tri vitet e fundit.

**Pasqyra e përmbledhur e pozitës financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor**

	2021 €'milion	2020 €'milion	2019 €'milion
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Pasuritë e paprekshme	48	40	36
Prona, fabrika dhe paisjet	<u>216</u>	<u>206</u>	<u>176</u>
	264	246	212
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	294	303	237
Llogaritë e arkëtueshme	160	141	105
Paraja	<u>52</u>	<u>58</u>	<u>52</u>
	<u>506</u>	<u>502</u>	<u>394</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>770</b>	<b>748</b>	<b>606</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<i>Ekuiteti</i>			
Kapitali aksionar	100	100	100
Fitimet e mbajtura	<u>346</u>	<u>330</u>	<u>299</u>
	446	430	399
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Kreditë afatgjata	138	138	74
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Të pagueshmet tregtare	75	75	53
Të pagueshmet tjera	<u>111</u>	<u>105</u>	<u>80</u>
	<u>186</u>	<u>180</u>	<u>133</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>770</b>	<b>748</b>	<b>606</b>

**Kërkohe:**

**Shkruani një raport për drejtorin ekzekutiv të Pacaya sh.a-së që:**

- a) **Analizon performancën dhe pozitën financiare të Pacaya sh.a-së duke treguar llogaritjet e koeficientëve në shtojcë të raportit. (15 pikë)**
- b) **Trego pesë (5) fusha që kërkojnë investigim të metutjeshëm për të plotësuar analizën e juaj të Pacaya sh.a-së në kërkesën a) më sipër, duke iu referuar informatave të cilat ju i keni paraqitur në raport. (5 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**

a)

**Për: Drejtorin Ekzekutiv**

**Nga: Kontrollori financiar**

**Tema: Analiza e Performancës së Pacaya sh.a nga 2019 deri në 2021**

## **Hyrje**

Ky raport i performancës ka të bëjë me pasqyrat financiare të Pacaya sh.a për periudhën 2019 - 2021. Raporti mbulon rentabilitetin, efikasitetin operativ, likuiditetin dhe solventitetin e Pacaya sh.a gjatë periudhës në shqyrtim. Këtij raporti i është bashkangjitur një shtojcë e cila tregon koeficientët e llogaritur si pjesë e analizës së performancës.

## **Rentabiliteti**

Marzha bruto e fitimit ka mbetur relativisht statike gjatë tre viteve, megjithëse u rrit me afërsisht 1pp në 2021. KNKA, ndërsa u përmirësua shumë lehtë në 2020 në 21.5%, ka rënë në mënyrë dramatike në 2021 në 17.8%. Marzha e FPIT ka rënë gjithashtu në vitin 2021, pavarësisht përmirësimit të marzheve të fitimit bruto. Kjo tregon një rritje të shpenzimeve që sugjeron se ato nuk janë të kontrolluara mirë. Përdorimi i pasurive krahasuar me qarkullimin e krijuar gjithashtu ka rënë, duke reflektuar rënien e aktivitetit tregtar midis 2020 dhe 2021

## **Efikasiteti operativ**

Është e dukshme se ka pasur një rritje dramatike të aktivitetit tregtar midis 2019 dhe 2020, por më pas një rënie të ndjeshme në vitin 2021. Si rezultat, të ardhurat u rritën me 17% në 2020, por ranë me 7% në 2021. Arsyet për këtë luhajtje janë të paqarta. Mund të jetë efekti i një lloji ngjarjeje të vetme, ose mund të jetë efekti i një ndryshimi në përzierjen e produktit. Cilado qoftë arsyeja, duket se kushtet e përmirësuar të kredisë për klientët (periudha e pagesës së të arkëtueshmeve nga 46 në 64 ditë) nuk e kanë ndaluar rënien e shitjeve.

## **Likuiditeti**

Si koeficienti qarkullues e ashtu edhe koeficienti i shpejtë tregojnë një situatë adekuate të kapitalit qarkullues, megjithëse koeficienti i shpejtë tregoi një rënie të lehtë. Kjo për shkak se ka pasur një rritje të investimit gjatë periudhës në stoqe dhe të arkëtueshme, të cilat janë financuar vetëm pjesërisht nga periudha më të gjata pagese për të pagueshmet tregtare dhe një rritje në të pagueshmet e tjera (kryesisht midis 2020 dhe 2021).

## **Solventiteti**

Niveli i leverazhit të kompanisë u rrit kur u morën €64 milion të tjera në kredi afatgjata në 2021 për t'iu shtuar €74 milion që tashmë janë në pasqyrën e pozitës financiare. Megjithëse ky nuk duket të jetë një nivel veçanërisht i lartë i leverazhit, raporti borxh/ekuitet u rrit nga 18.5% në 32.0% në 2021. Shpenzimet e interesit në 2021 janë rritur në €19 milion nga €6 milion qw ish në 2019. Shpenzimet e interesit në 2020 ishin €15 milion, duke sugjeruar që ose norma e interesit të huasë është variabile ose që shpenzimet e plota të interesit nuk janë ngarkuar në vitin 2021 (pra kredia nuk është përdorur tërë vitin). Huaja e re afatgjatë duket se ka financuar zgjerimin si në pasuritë fikse ashtu edhe në ato qarkulluese në 2021.

## Shtojca

Koeficienti	Llogaritja	2021	2020	2019
Marzha e fitimit bruto	(1)	35.40%	34.30%	34.00%
KNKA	(2)	17.80%	21.50%	21.10%
Marzha e FPIT	(3)	11.40%	12.40%	11.90%
Qarkullimi i pasurive	(4)	1.56%	1.73%	1.78%
Koeficienti i leverazhit	(5)	23.60%	24.30%	15.60%
Koeficienti borxh/ekuitet	(6)	30.90%	32.00%	18.50%
Mbulimi i interesit	(7)	5.5	8.1	16.7
Koeficienti qarkullues	(8)	2.7	2.8	3.0
Koeficienti i shpejtë	(9)	1.1	1.1	1.2
Periodha e arkëtimit të LL/A (ditë)	(10)	64	52	46
Periodha e qarkullimit të stoqeve (ditë)	(11)	182	171	156
Periodha e pagimit të LL/P (ditë)	(12)	46	42	35

Llogaritjet	2021	2020	2019
1 Marzha e fitimit bruto	323/913 x 100	336/981 x 100	286/840 x 100
2 KNKA*	100/584 x 100	122/568 x 100	104/473 x 100
3 Marzha e FPIT	104/913 x 100	122/981 x 100	100/840 x 100
4 Qarkullimi i pasurive	913/584	981/568	840/473
5 Koeficienti i leverazhit	138/(138+446) x 100	138/(138+430) x 100	74/(74+399) x 100
6 Koeficienti borxh/ekuitet	138/446 x 100	138/430 x 100	74/399 x 100
7 Mbulimi i interesit	104/19	122/15	100/6
8 Koeficienti qarkullues	506/186	502/180	394/133
9 Koeficienti i shpejtë	212/180	199/180	157/133
10 Periodha e arkëtimit të LL/A	160/913x365	141/981x365	105/840x365
11 Periodha e qarkullimit të stoqeve	294/590x365	303/645x365	237/554x365
12 Periodha e pagimit të LL/P	75/590x365	75/645x365	53/554x365

\* KNKA është llogaritur si: Fitimi para interesit dhe tatimit (FPIT) / Kapitali i angazhuar

### b) Fushat për invetigim të metutjeshëm përfshijnë si më poshtë;

- i) Kredia afatgjatë: Nuk ka asnjë tregues se përse është marrë kjo kredi dhe si është përdorur për financimin e biznesit. Detaje të mëtejshme nevojiten për normat e interesit, siguria që është dhënë dhe datat e shlyerjes.
- ii) Aktiviteti tregtar: Niveli i shitjeve ka pasur luhatje në mënyrë krejt të çuditshme, duke kërkuar hetim dhe shpjegim të mëtejshëm. Faktorët që duhen marrë parasysh do të përfshijnë politikat e çmimeve, përzierjen e produkteve, pjesëmarrjen në treg dhe çdo dukuri unike që do të ndikonte në shitje.
- iii) Analizë e mëtejshme: Do të ishte e dobishme të zërtheheshin disa nga informacionet në pasqyrat financiare, ndoshta në një format të kontabilitetit të menaxhimit. Shembujt do të përfshijnë sa vijon.

- Shitjet sipas segmentit, tregut apo zonës gjeografike
- Kostoja e shitjeve e ndarë në lëndë të para, punë dhe shpenzime të përgjithshme

- Stoqet e ndara në lëndë të para, punë në vazhdim dhe mallra të gatshme
- Shpenzimet e analizuara ndërmjet kostove administrative, shitjeve dhe kostove të shpërndarjes.

- iv) Politikat kontabël: Politikat kontabël mund të kenë një efekt të rëndësishëm në zëra të caktuar. Në veçanti, do të ishte e dobishme të dihej se cilat janë politikat kontabël në lidhje me pasuritë jo-qarkulluese (dhe nga çfarë përbëhen këto pasuri) dhe nëse ka pasur ndonjë ndryshim në politikat kontabël.
- v) Politika e dividendës: Pacaya sh.a ka mbajtur pagesat e dividendëve për aksionerët gjatë tre viteve. Me sa duket, Pacaya sh.a do të kishte qenë në gjendje të zvogëlonte shumën e borxhit afatgjatë të marrë nëse do të kishte mbajtur një pjesë ose të gjithë dividendat gjatë kësaj periudhe. Do të ishte interesante të shqyrtohet lëvizja e çmimit të aksionit gjatë periudhës dhe të llogaritet mbulimi i dividendës.